# KONTRATE
## PER THEMELIMIN E SHOQERISE
## "NUISANCE CALL BLOCKER " sh.p.k.

E lidhur sot me date 05 gusht 2014 nga :

1. Z. Artur HOXHOSMANI

Me cilesine e ortakut te vetem ra dakord qe kontratën e themelimit te shoqërisë ta formulojë sipas kërkesave te ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 date 14.04.2008, dhe ligjin nr 9723 date 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare te Rregjistrimit " , dhe vendosi sa me poshtë:

NENI 1

Te krijojnë shoqërinë tregtare me Përgjegjësi te Kufizuar " NUISANCE CALL BLOCKER " sh.p.k., e cila do te veproje ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kësaj kontrate, me statutin bashkëngjitur kësaj kontrate, me ligjin "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008 dhe formalitetet qe duhen plotësuar ne te.

Kjo shoqëri do te emërtohet " NUISANCE CALL BLOCKER " sh.p.k.

NENI 2

Shoqëria " NUISANCE CALL BLOCKER " sh.p.k. do te ketë Qendrën ne Lagjen nr 3, rruga Egnatia, Pallati Xhorxh ALEKSIT, sh 1, K 2 , Ap 1, perballe Institutit te Peshkimit Durrës, dhe do te ushtroje veprimtarinë e saj private për një periudhe kohore mbi 10 vjet, ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 3

Shoqëria do te ketë për objekt te veprimtarisë te saj ushtrimin e aktivitetit privat ne fushën e :

Call Center, kreyrjen e shërbimeve të shitjes së produktit me anë të video call, telefonatave dhe me anë te telemarketing si dhe pajisje zyrash teleperformance etj

Import Eksport, shitje – blerje mallrash , si dhe cdo aktivitet tjetër që lidhet me objektin e mësipërm, kryerjen e shërbimeve përkatëse në lidhje me to.

Shoqëria mund të kryejë për përmbushjen e qëllimeve te saj cdo operacion tregtar, mund të vejë pasuri të luajtshme dhe të paluajtëshme, t'a hipotekojë këtë pasuri në rregjistrin e

pasurive të paluajtshme në emër të saj. Mund të hyj në tratativa dhe biznese me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objekt veprimatrie për të realizuar fitime në fushën e aktivitetit të saj. Të marrë pjesë në ankande apo prokurime publike të zhvilluara nga organet përkatëse shtetërore sipas legjislacionit shqiptar.

NENI 4

Shoqëria mund te ndryshoje emërtimin, vendqëndrimin, selinë, kohëzgjatjen, pjesëmarrjen e kuotave, objektin e veprimtarisë se saj, me vendim te ortakeve sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë do te jete: 100 ( Njëqind) lekë të reja dhe është ndare si me poshtë vijon :

1. Artur HOXHOSMANI me 100 % te kuotave = ( 100 leke)

Te gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar e shlyer krejtësisht.

Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

NENI 6

Kapitali i shoqërisë mund te shtohet ose te pakësohet sipas vendimeve qe do te marrin ortaku.

Ne rast se kapitali i shoqërisë për shkak te humbjeve te vërtetuara ne dokumentet financiare, rezulton me i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku vendos brenda tre muajve nga miratimi i llogarive te përcaktojnë këtë humbje mbi mundësinë e prishjes se parakohshme te shoqërisë.

Ne rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlere jo me te vogël se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

NENI 7

Organet drejtuese te shoqërisë jane:

- Asambleja e ortakut;
- Administratori .

Procedura për emërimin ne funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqërisë.

NENI 8

Ortaku themelues te Shoqërisë kane zgjedhur si administrator te shoqërisë zotit Artur HOXHOSMANI i biri i Shefqetit , ditëlindja 08/04/1983 me karte identiteti nr 031895171 .

Administratori zgjidhet për 5 vjet kohe me te drejte ripërtëritjeje

NENI 9

Vendimet e Ortakut janë te vlefshme ne se janë miratuar nga ortaku i saj sipas dispozitave te Ligjit Për Shoqëritë Tregtare ne lidhje me pjesëmarrjen dhe shumicën e votave sipas kuotave ne kapitalin themeltar për Asamblenë e Zakonshme dhe te Jashtëzakonshme. Mënyra e thirrjes se Asamblesë se Zakonshme dhe te Jashtëzakonshme, kompetencave te ortakeve dhe marrjes se vendimeve do te bazohet ne statutin e shoqërisë si dhe ne Ligjin "Për shoqëritë tregtare".

NENI 10

Likuiditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqëria ka llogarite e saj rrjedhëse.

Për kapitalin themeltar te shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do te shënohet kontributi i secilit ortak. Po kështu shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave te ligjit për kontabilitetin si dhe gjithë kërkesave te tjera financiare, te domosdoshme për veprimtarinë normale te saj.

NENI 11

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria do te ndahet ndërmjet ortakeve ne përpjesëtim me kontributin e secilit ne kapitalin themeltar te shoqërisë, mbasi te jene likuiduar te gjitha detyrimet, dhe te jete hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezervës ligjore deri ne përmbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqërisë.

NENI 12

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi te ketë marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 14

Ortaku eshte i detyruar detyruar te ruaj karakterin sekret te dokumentacionit, te eksperiencës se shkëmbyer, te realizuar brenda veprimtarisë te shoqërisë.

NENI 15

Te gjitha mosmarrëveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirëkuptim do te paraqiten për zgjidhje ne gjykatën kompetente shqiptare ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 16

Ne rast zgjidhje te kontratës, Ortaku i vetem përcakton mënyrën e likuidimit dhe emëron një ose me shume likuidatorë sipas normave ligjore.

NENI 17

Kjo kontrate u përpilua ne prani te ortakut te vetem duke shprehur ne te vullnetin e lire dhe te plote te tije.

NENI 18

Kontrata u përpilua ne katër kopje me fuqi te barabarte secila, për t'u depozituar ne Q K.R, Degën Rajonale Tatimore, zyrën e noterisë si dhe një kopje ruhet ne dokumentacionin baze te shoqërisë.

Ortaku themelues , autorizojnë z Artur HOXHOSMANI për te kryer veprimet përkatëse për regjistrimin e kësaj shoqërie si person juridik pranë Q.K.R-se

ORTAKU I VETEM

Artur HOXHOSMANI

Artur Hoxhosmani